

**STATUTI DHE AKT THEMELIMI**  
**ISHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR**  
**“GLOBAL-OP” SH.P.K**

Ne perputhje me Ligjin nr. 9901 date 14.04.2008, ‘‘Per tregtaret dhe shoqerite tregtare’’, i ndryshuar dhe ligjin Nr. 9723 date 03.05.2007’’Per Qendren Kombetare te Regjistrimit’’, te ndryshuar, themelohet Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar ‘‘GLOBAL -OP’’ SH.P.K nga ortaket

1.ELVIRA PERGJONI me nr identifikimi **J05812061P** lindur me 12.08.1990 ne Kurbenesh Mitdite dhe vendbanimi aktual:Rr ‘‘Bedri Karapici’’nr pasurise 4/166 Zona kadastrale 8240 Qyteti i nxensve Kombinat Tirane.

2. GEORGES OBEID me nr indetifikimi **LR2511159** lindur me 29.04.1986 ne Hayata LIBAN vendbanimi aktual : HAYATA LIBAN.

Shoqeria eshte person juridik i te drejtes shqiptare dhe gezon te drejttat e personit juridik nga data e regjistrimit ne Qendren Kombetare te Regjistrimit. Shoqeria zhvillon aktivitetin e saj ne perputhje te plote me legjislacionin shqiptar dhe dispozitat e aktit te themelimit e te ketij statuti.

Neni 1

**EMERTIMI**

Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar do te emertohet ‘‘GLOBAL-OP’’ SH.P.K

Neni 2

**OBJEKTI I VEPRIMTARISE**

**NE FUSHEN E AGROKULTURES:**

- **AGJENSI PUNESIMI Brenda edhe jashte vendit.**
- **AGROKULTURE : DRITHERA BUKE, GRURE, MISER**
- **PUNIME NDERTIMI E SHERBIME DHE furnizim materialesh per ndertimi import export.**
- **KOMPANI PASTRIMI PER OBJEKETE Shtetrorre edhe private**
- **FRUTIKULTURE: Prodhim frutash te gjitha llojeve edhe tregtimi I tyre**
- **PERIME: Prodhimi I perimeve te te gjitha llojeve edhe tregtimi I tyre**
- **BLEGTORI: Mbarshtim BLEGTORIE, dhe tregtimi I produkteve blektorale**
- **IMPORTE DHE EXPORTE: Te gjitha lloji e prodhime bujqesore e blegtorle, perime , fruta e tjera prodhime te ndryshme ( ushqimore, detergjent,**
- **KOMPANI PASTRIMI PER OBJEKETE Shtetrorre edhe private**
- **PUNIME NDERTIMI E SHERBIME DHE furnizim materialesh per ndertimi import export.**
- **Tregeti: Te te gjitha llojeve,ushqimore, veshmbathje . butik, hotele, guzhina, restorante e tjera.**
- **Importe: Te gjitha llojeve, transporte,ushqimore, vashmbathje, elektrike, hidraulike, kancelari, pllaka, mjete dhe tregtimi i tyre.**

Neni 3

**SELIA E SHOQERISE**

Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar ka seline e saj ne adresen: **Rruga‘‘Bedri Karapici ‘‘** Zona kadastrale nr 8240 nr pasurise 4/166 ndertese 3 kateshe kati I re Qyteti Nxenseve Lagja 6 Kombinat Tirane ka te drejte transferoje, apo te suprimoje qendra administrative, seli, filiale, agjensi dhe zyra ne territorin e Republikes se Shqiperise dhe jashte vendit

Neni 4

**KOHEZGJATJA**

Kohezgjatja e veprimtarise se shoqerise do te jete pa afat, me mundesine e zgjatjes apo te shkurtimeve te afateve, te ndryshoje veprimtarine, emertimin, seline, objektin e veprimtarise sipas vendimit te ortakeve te shoqerise

Neni 5



## KAPITALI THEMELTAR

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 1.000.000 leke, i ndare ne kuota te barabarta te zoteruara perkatesisht 1 kuote nga ortaku ELVIRA PERGJONI me 50% ose ne vlere 500.000 leke dhe 1 kuote GEORGES OBEID me 50% ne vlere me 500.000.

- Ky kapital eshte shlyer teresisht nga ortaket themelues.

### NENI 6

#### Zmadhimi dhe Zvogëlimi i Kapitalit Themeltar

(1) Kapitali i shoqerise mund te zmadhohet nepermjet nenshkrimeve te pjeseve te kapitalit themeltar per kontributet ne para dhe me ane te kontributeve ne natyre, nepermjet emerimit nga gjykata kompetente te nje eksperti te autorizuar per keto kontribute sipas kerkeses se administratorit.

(2) Shoqëria mund të vendosë zvogëlimin e kapitalit themeltar me vendimin e Asamblesë së Ortakeve, duke marrë me shumicën e kualifikuar të votave. ne te gjitha rastet zvogelimi i prek ortaket ne te njejten mase ndaj pjeseve te kapitalit qe perfaqesojne.

### Neni 7

#### TRANSFERIMI I KUOTAVE

Ortaket mund te kalojne pjesen nga kapitali themeltar ndaj personave te Trete ne perputhje me rregullat e parashikuara ne nenin 73 te ligjit 9901 date 14.04.2008''Per tregtaret dhe shoqerite tregtare''. Kuota dhe te drejtat qe rrjedhin prej saj mund te fitohen apo kalohen nepermjet:

- kontributit ne kapitalin e shoqerise
- shitblerjes
- trashegimise
- dhurimit
- cdo menyre tjeter te parashikuar me ligj

Pjeset e kapitalit themeltar jane lirisht te transferueshme ndermjet ortakeve.

### Neni 8

#### DETYRIMET E ORTAKEVE

Ortaket e shoqerise duhet te kryeje depozitimn e kapitalit themeltar per llogari te shoqerise ne nje banke te caktuar prej tyre.

#### Ortaku gezon keto te drejta kryesore:

- Pjesmarrjen ne rezultatet e çdo forme dhe sasie te veprimtarise se shoqerise e parashikuar ne kontraten dhe statutin e saj.
- Marrjen e te gjitha te dhenave qe kane te bejne me gjendjen ekonomike tregtare dhe veprimtarine e shoqerise, si dhe me te gjitha dokumentat e perpunuara nga shoqeria, bilancet si dhe llogarite ekonomike etj.
- Paraqitjen e propozimeve dhe shqyrtimin e tyre nga Mbledhja e Asamblese se Ortakut.
- Te heqi dore nga shoqeria.
- Heqja dore nga shoqeria nuk e liron ortakun nga detyrimet financiare te marra me pare ndaj shoqerise.
- Te marri pjese ne organet e shoqerise qe jane ose mund te krijohen nepermjet perfaqesuesve te tij ose vete.
- Te kerkoje t'i jepen te gjitha informatat qe kane te bejne me gjendjen prodhuese dhe tregtare te shoqerise, si dhe te gjitha dokumentat e perpunuara te shoqerise, si bilancet, llogarite ekonomike etj.
- Te beje propozime dhe t'i paraqesi ato per shqyrtim para organeve te shoqerise.
- Te emeruje dhe te shkarkoje perfaqesuesit e tij, punonjesit, ekspertin kontabel dhe likuidatoret.

#### Ortaku ka keto detyrime kryesore:

- Te depozitoje kuoten e tij ne perputhje me kontraten dhe statutin.

- Te marri pjese ne administrimin e shoqerise nepermjet organeve te krijuara nga vete ai.
- T'i japi shoqerise te dhenat e domosdoshme per perpunimin e çdo objekti te vecante lidhur me veprimtarine e saj.
- Te kryeje detyrat per realizimin e objektivave dhe te funksioneve te shoqerise.
- Ortaku ka te drejte te heqe dore nga shoqeria, duke i njoftuar vendimin e tij asamblese se ortakut ne rast shtimi te ortakeve 6 muaj perpara dhe duke ceduar te drejten e zgjedhjes.
- Heqja dore nuk e liron ortakun nga detyrimet e marra me pare ndaj shoqerise dhe nuk pezullon detyrimet e shoqerise ndaj ortakut.
- Ti japi shoqerise informatat e nevojshme qe kane te bejne me ecurine e veprimtarise se saj.
- Te kryeje sherbimet e nevojshme per arritjen e objektivave te shoqerise dhe realizimin e funksioneve te saj.
- Pjesemarrja ne shoqeri nuk i pengon ortakut te kene pavaresi ligjore per veprimtari te tjera dhe per te drejta te tjera pronesie. Ai nuk pergjigjet per detyrimet e shoqerise qe rrjedhin nga objekti i veprimtarise se saj tej kapitalit themelor ku ata kane marre pjese.

Neni 9

### OPERACIONET FINANCIARE

Shoqeria eshte e autorizuar per te siguruar mjete financiare ti drejtohet bankave, institucioneve te kreditit ose atyre te financimeve totale apo te jashtme, institucioneve nderkombetare te financimit dhe te kreditit sido qe te jete percaktuar.

Neni 10

### BLERJET E SHOQERIVE

Shoqeria disponon mjetet e saj ne perputhje me destinacionin e tyre dhe me objektin e shoqerise. Ne Republiken e Shqiperise, shoqeria gezon te drejten e saj per te zoteruar mjete te saj si ne cdo shoqeri tjeter ose organizate tregtare, kombetare shqiptare ne perputhje me Ligjin 9901 date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", i ndryshuar.

### FONDI REZERVE

Neni 11

Shoqeria mund te themeloje nje fond rezerve si dhe fonde te tjera te vecanta per zhvillimin e tij. Perberja, shuma totale, fondet per krijimin e tyre perdorimi dhe rregullimi i tyre (i cdo fondi) percaktohet nga Asambleja e ortakeve ne perputhje me legjislacionin shqiptar. Vlerat materiale te shoqerise raportohen ne bilance te shprehur ne leke shqiptare, ne perputhje me rregullat ne fuqi ne Republiken e Shqiperise. Bilanci dhe perlllogaritjet ekonomike te shoqerise hartohen mbi bazen e formes se bilancit dhe llogaritjeve ekonomike te percaktuara per shoqerite tregtare ne Shqiperi. Bilanci vjetor mbyllet ne 31 dhjetor te cdo viti.

### ORGANET E SHOQERISE

Neni 12

Organi vendimmarres i shoqerise eshte Asambleja e Ortakeve.

Asambleja e pergjithshme eshte pergjegjese per marrjen e vendimeve per shoqerine per çeshtjet e mëposhtme:

- a) percaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) percaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "ç" të kësaj pike;
- dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;

i) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

Asambleja e përgjithshme merr vendime për çështjet e përcaktuara në shkronjat “e” dhe “ë” të pikës 1 të këtij neni, pas marrjes dhe shqyrtimit të dokumenteve përkatës. Të gjitha vendimet e marra nga Asambleja e Ortakëve regjistrohen në një regjistër të vendimeve, të dhënat e të cilit nuk mund të ndryshohen ose të fshihen.

Duhet regjistruar në veçanti, por pa u kufizuar nëto, vendimet për:

- a) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- b) shpërndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;
- c) investime;
- ç) vendimet për riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Vendimet e paregjistruara në regjistrin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme. Shoqëria nuk mund t'i kundrejtojë pavlefshmërinë të tretit, që ka fituar të drejta në mirëbesim, përveç rastit kur shoqëria provon se i treti ka pasur dijeni për pavlefshmërinë, apo në bazë të rrethanave të qarta nuk mund të mos kishte pasur dijeni për të.

## **MBLEDHJA E ASAMBLESË SË PËRGJITHSHME**

Neni 13

Asambleja e përgjithshme mbledhet në rastet e përcaktuara nga ligji 9901, date 14.04.2008, nga ligje të tjera dhe sa herë që mbledhja është e nevojshme për të mbrojtur interesat e shoqërisë. Mbledhja e zakonshme e asamblesë së përgjithshme thirret të paktën një herë në vit.

Asambleja e përgjithshme thirret nga administratorët apo ortakët e përcaktuar sipas nenit 84 të Ligjit për Shoqëritë Tregtare. Asambleja e përgjithshme thirret nëse, sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim. Asambleja e përgjithshme thirret kur shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktivet, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 për qind të asetëve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara. Asambleja e përgjithshme thirret kur shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të asetëve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.

Në rastet e parashikuara në pikat 3 deri në 5 të këtij neni, asambleja e përgjithshme mund të miratojë një rezolutë këshilluese, duke miratuar apo bërë vërejtje për veprimtarinë e administratorëve.

## **MËNYRA E THIRRJES**

Neni 14

Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.

Kur Asambleja e Përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës 1 të këtij neni, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

## **KËRKESA NGA ORTAKËT E PAKICËS**

Neni 15

Ortakët, të cilët përfaqësojnë të paktën 5 për qind të totalit të votave në asamblenë e përgjithshme të shoqërisë, apo një pjesë më të vogël të parashikuar në statut, mund t'i drejtojnë administratorëve një kërkesë me shkrim, përfshirë postën elektronike, për të thirrur asamblenë e përgjithshme dhe/ose përfshirjen e çështjeve të posaçme në rendin e ditës. Kërkesa duhet të përmbajë arsyet, objektivat dhe çështjet, për të cilat asambleja duhet të marrë një vendim. Nëse kërkesa refuzohet, këta ortakë kanë të drejtë ta thërrasin asamblenë dhe të caktojnë çështjet e rendit të ditës, në përputhje me pikën 1 të nenit 83 të këtij ligji. Nëse, në kundërshtim me pikën 1 të këtij neni, asambleja e përgjithshme nuk thirret, ose çështja e kërkuar prej këtyre nuk futet në rendin e ditës, secili prej ortakëve, që kanë bërë

kërkesën, ka të drejtë:

a) të ngrejë padi në gjykatë, për të deklaruar shkeljen e detyrimit të besnikërisë, nëse administratorët nuk përmbushin kërkesat e ortakëve brenda 15 ditëve;

b) t'i kërkojë shoqërisë blerjen e kuotave, të zotëruara prej tyre.

Në rastet kur rendi i ditës ndryshohet, sipas parashikimeve të pikave 1 e 2 të këtij neni dhe thirrja i është njoftuar ortakëve, administratorët njoftojnë përsëri rendin e ditës, të ndryshuar, në përputhje me parashikimet e ketij statutit.

Përfaqësuesi i autorizuar është i detyruar të deklarojë çdo fakt apo rrethanë, të tillë që, sipas gjykimit të ortakut të përfaqësuar, rrezikon të ndikojë në vendimmarrjen e përfaqësuesit për interesa të tjerë të ndryshëm nga ata të ortakut të përfaqësuar.

## PËRFAQËSIMI NË ASAMBLE

Neni 16

Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.

Administratorët e shoqërisë nuk mund të veprojnë si përfaqësues të ortakëve në asamblenë e përgjithshme.

Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

## KUORUMI

Neni 17

Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30 për qind të kuotave. Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar, sipas nenit 87 të Ligjit 9901, date 14.04.2008, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të ligjit Nr. 9901, date 14.04.2008.

Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur në pikën 1 të këtij neni, asambleja mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

## MARRJA E VENDIMEVE

Neni 18

Me përjashtim të rasteve kur statuti parashikon një shumicë më të lartë, asambleja e përgjithshme vendos me tri të katërtat e votave të ortakëve pjesëmarrës, siç përcaktohet në pikën 1 të nenit 86 të ligjit nr. 9901, date 14.04.2008, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në ligj ose në statut, për çështjet e tjera të renditura në nenin 81 të ligjit për shoqëritë tregtare, asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës.

Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në ligj, vlefshmëria e vendimeve, që përcaktojnë detyrime shtesë mbi ortakët, apo vendimet që kufizojnë të drejtat e tyre, të parashikuara në këtë ligj ose në statut, kushtëzohet nga miratimi i ortakut përkatës.

## PROCESVERBALET E MBLEDHJES SË ASAMBLESË

Neni 19

Të gjitha vendimet e asamblesë së përgjithshme duhet të regjistrohen në procesverbal. Administratorët përgjigjen për ruajtjen e kopjeve të procesverbaleve të mbledhjeve të asamblesë së përgjithshme.

Procesverbali duhet të përmbajë datën e vendin e mbledhjes, rendin e ditës, emrin e kryetarit e të mbajtësit të procesverbalit, rezultatet e votimit.

Procesverbalit i bashkëlidhet edhe lista e pjesëmarrësve, si edhe akti i thirrjes së asamblesë së përgjithshme.

Procesverbali i mbledhjes nënshkruhet nga kryetari dhe nga mbajtësi i procesverbalit.

Nëse shoqëria ka publikuar një faqe në internet, administratorët, jo më vonë se 15 ditë nga data e mbledhjes, janë të detyruar të publikojnë kopje të procesverbalit të mbledhjes së asamblesë së përgjithshme në këtë faqe.

### **ADMINISTRATORI**

Neni 20

Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar administrohet nga një ose disa persona fizike.

Administratori i shoqërisë emerohet me vendim të Asamblesë së Ortakëve të shoqërisë. Afati i qendrimit në detyrë të administratorit të shoqërisë është për një periudhë 5 (pese) vjetore.

Administratori i kësaj shoqërie është **ELVIRA PERGJONI** me ID.J05812061P

Administratori i shoqërisë i ka të gjitha kompetencat për të vepruar në mardhenie me të tretet në emër të shoqërisë, në të gjitha rrethanat, me përjashtim të kompetencave që u njeh ligji shprehimisht Asamblesë së Ortakëve ose të treta.

Administratori ka përgjegjësi ndaj shoqërisë ose ndaj të treta për shkeljetë ligjeve, statutit apo shkeljeve të kryera gjatë administrimit. Administratori në rastin konkret kryen dhe harton raportet financiare, llogarite vjetore etj.

### **RAPORTET E PUNES**

Neni 21

Raportet e punës ndërmjet shoqërisë, filialeve dhe agjensive të saj si dhe të punonjësve në të, rregullohen në bazë të kontratës së punës, konform Kodit të Punës.

Për sa nuk parashikohet në kontratën e punës, aplikohen dispozitat e legjisllacionit shqiptar në fuqi.

Shoqëria merr përsipër, të shlyejë rregullisht të gjitha detyrimet e saj që burojnë nga legjisllacioni për sigurimet shoqërore e shëndetësore lidhur me të punësuarit e saj.

### **PERFUNDIMI I AKTIVITETIT**

Neni 22

Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar prishet:

1.Me kalimin e afatit për kohezgjatjen e saj në kontratën e themelimit.

2.Për pamundësinë e realizimit të objektit të saj.

3.Me vendimin e gjykatës.

4.Me hapjen e procedurave të falimentit.

### **LIKUJDIMI**

Neni 23

Likujdimi i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar do të bëhet sipas normave të legjisllacionit shqiptar në fuqi në kohën e likujdimit

### **KUSHTET E TJERA**

Neni 24

Të gjitha vendimet e mara nga asambleja e ortakëve të shoqërisë evidentohen në një libër të vecantë, i cili administrohet në selinë e shoqërisë.

Për sa nuk është shprehur plotësisht dhe saktësisht në këtë, statut do të referohen plotësisht që mund të bëjë Asambleja e ortakëve, si dhe ligjeve të vecanta të legjisllacionit shqiptar në fuqi.

Për shoqërinë tregtare “GLOBAL-OP” SH.P.K

### **ORTAKET E SHOQËRISË**

**ELVIRA PERGJONI GEORGES OBEID**

Tirane, me 10.6.2023